



DEKLARATË POLITIKE

PËR ZGJEDHJET KOMUNALE PËR KRYETAR KOMUNE DHE KUVENDE KOMUNALE, 2017

VIZIONI

PDK, në zgjedhjet komunale për Kryetar Komune dhe Kuvende Komunale, krijon mundësi për zhvillimin e vazhdueshëm e cilësor të shërbimeve komunale, atyre publike, infrastruktures komunale, arsimit, biznesit, mirëqenies ekonomike-sociale dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore, duke ruajtur ambientin dhe trashëgiminë kulturo-historike.

MISIONI

PDK punon që komunat, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi kushtetuese e ligjore që ka, si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, të kujdeset që qytetarët e vet të të gjitha komuniteteve, të gjinive dhe orientimeve të tyre personale, t'i gëzojnë të drejtat dhe mundësitë e barabarta në shërbimet komunale në të gjitha nivelet.

Qëllimet dhe Objektivat

Përmirësimi cilësor i shërbimeve komunale e publike dhe infrastrukturore, Zvogëlimi në vazhdimësi i ekonomisë informale, Kompletimi i planeve rregulluese, Subvencionimi i fermerëve, Analiza e burimeve natyrore të komunave, Mbështetja e aktiviteteve të veçanta rinore, sportive dhe kulturore.

Personi kontaktues i subjektit politik